

VENDIM
Nr. 603, datë 14.9.2022

**PËR KALIM FONDI MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË PËR
MBËSHTETJEN E SEKTORIT ENERGJETIK, FAZA II**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin 04320, “Mbështetje për energjinë”, në llogarinë ekonomike nr. 232, i shtohet fondi 8 000 000 000 (tetë miliardë) lekë, në formën e transferimit në kapital (transhi i dytë nga fondi i miratuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit), për shoqërinë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)” sh.a., me qëllim mbulimin me likuiditet të veprimtarisë operationale të shoqërisë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga zëri “Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik”, miratuar në buxhetin e vitit 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku